

Statistikat e Transportit Detar

Tremujori IV, 2025

Tiranë, më 30 Janar 2026: Në Shqipëri operojnë katër porte detare, të cilët shërbejnë për **transport mallrash**:

Porti i Durrësit, Vlorës, Shëngjinit dhe porti i Limjonit (Sarandë). Porti i Durrësit është porti kryesor në vend, prej të cilit, gjatë tremujorit të katërt 2025, janë transportuar 93,8 % e volumit të mallrave të transportuar me det, ose 1.999 mijë ton mallra. Volumi gjithsej i mallrave të transportuara nga porti i Durrësit është rritur me 5,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1: Volumi i mallrave sipas porteve detare, 000/ton

	TR IV – 2023	TR I- 2024	TR II- 2024	TR III- 2024	TR IV- 2024	TR I- 2025	TR II- 2025	TR III- 2025	TR IV- 2025
Portet	1.739	1.673	2.142	1.924	2.008	1.643	2.205	2.247	2.130
Porti Durrës	1.641	1.606	2.034	1.818	1.895	1.553	2.063	2.135	1.999
Import	1.254	1.280	1.634	1.490	1.605	1.275	1.743	1.823	1.689
Eksport	387	327	400	328	290	278	320	312	310
Porti Vlorë	44	38	45	51	45	32	73	55	56
Import	33	31	35	37	34	17	65	44	48
Eksport	11	7	10	14	11	15	8	11	8
Porti Sarandë (Limjoni)	10	9	10	0	15	10	11	1	10
Import	10	9	10	0	12	10	11	1	10
Eksport	0	0	0	0	3	0	0	0	0
Porti Shëngjin	44	20	54	55	53	49	57	56	66
Import	32	13	35	37	37	27	38	43	54
Eksport	12	7	19	18	16	22	19	13	12

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

*Në të dhënat e Portit të Durrësit përfshihet edhe volumi i mallrave të transportuara nga Porti koncensionar i Porto Romanos

Llojet e grup-mallrave kryesore të transportuara nëpërmjet rrugëve detare, sipas klasifikimit NST 2007 (Nomeklatura e Statistikave të Transportit), për tremujorin e katërt 2025, paraqiten si më poshtë:

- Grupi i mallrave " Koks dhe produktet e rafinuara të naftës " përbën 15,2 % të mallrave të transportuara nga portet;
- Grupi "Metale bazë; produkte metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve" përbën 12,5 % të mallrave të transportuara nga portet;
- Grupi "Produkte të tjera minerale (jo metalike)" përbën 12,2 % të mallrave të transportuara nga portet;

Për publikim 30/01/2026

- Grupi i mallrave "Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror" përbën 11,3 % të mallrave të transportuar nga portet.

Tab.2: Transporti detar i mallrave sipas kategorive të NST 2007

Nr	Kategoritë e mallrave të transportuara në portet detare	Mallra gjithsej në ton	
		Tr IV-2024	Tr IV-2025
	Gjithsej	2.008.367	2.130.331
1	Produktet bujqësore, gjuetisë, pyjeve dhe peshku dhe produktet e tjera të peshkimit	22.977	31.418
2	Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror	116.230	240.705
3	Produktet metalike dhe të minierave dhe produkte të tjera të gurore; torfe; uranium dhe torium	18.713	12.908
4	Produkte ushqimore, pijeve dhe duhanit	42.099	33.325
5	Tekstile dhe produkte tekstili; lëkurë dhe produkte lëkure	763	183
6	Druri dhe produktet e drurit dhe produktet me tapë (përveç mobilie); artikujt prej kashte dhe materialeve thurës; pulpë, letër dhe produkte letre; materialet e shtypura dhe mediat e regjistruara	20.875	17.274
7	Koks dhe produktet e rafinuara të naftës	411.237	324.841
8	Kimikate, produkte kimike, dhe fibra të bëra nga njeriu; produkte gome dhe plastike, karburant bërthamor	40.128	15.359
9	Produkte të tjera minerale (jo metalike)	253.237	260.717
10	Metale bazë; produkte metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve	340.732	267.242
11	Makineri dhe pajisje; Pajisje zyre dhe kompjuter; makineri elektrike dhe aparatura si radio, televizion dhe pajisjet e komunikimit; instrumentet mjekësorë dhe orë	87	68.086
12	Pajisje transporti	7.454	11.114
13	Mobilie; mallra të tjerë të përpunuar të p.k.v	0	0
14	Lëndë të para të ricikluara; Mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturinat e tjera	5.317	7.489
15	Pako postare	0	0
16	Pajisje dhe materiale që përdoren në transportin e mallrave	34.557	0
17	Mallra të lëvizura në rrugën e zhvendosjes së familjeve dhe zyrave; bagazheve të transportuara të ndara nga ato të udhëtarëve; automjetet të transportuara për riparim; mallra jo tregtare të tjera.	0	0
18	Mallra të grupuara: një përzierje e llojeve të mallrave të cilat janë transportuar së bashku	11.589	10.082
19	Mallra të paidentifikuara: mallrat që për ndonjë arsye nuk mund të identifikohen dhe për këtë arsye nuk mund të caktohet në grupe 01-16.	682.372	829.587
20	Mallra të tjera të p.k.v	0	0

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

*Volumi i mallrave të transportuar me det përfshin mallrat e transportuar me anije dhe traget

Numri i anijeve të hyra dhe të dala nga portet në vend rezulton 268 anije, nga këto 253 anije janë të huaja dhe 15 anije vendase. Numri i anijeve të hyra dhe të dala në porte është rritur me 0,8 %, ku numri i anijeve të huaja është rritur me 7,7 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2024.

Portet detare ku kryhet **transporti pasagjerëve** në vend janë: Porti i Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe porti i Shëngjinit. Lëvizja e pasagjerëve në tremujorin e katërt 2025 është kryer nga porti i Durrësit, Vlorës dhe porti i Sarandës.

Tab.3: Transporti Detar i pasagjerëve

Pasagjerë	TR IV-2023	TR I-2024	TR II-2024	TR III-2024	TR IV-2024	TR I-2025	TR II-2025	TR III-2025	TR IV-2025
Portet gjithsej	197.377	135.680	298.175	950.100	211.371	133.503	330.630	1.010.888	221.628
Porti Durrës	127.603	109.722	117.200	417.670	130.324	108.312	133.178	412.930	137.119
Hyrje	77,087	43.203	62.561	197.440	76.846	40.882	71.312	194.406	82.459
Dalje	50.516	66.519	54.639	220.230	53.478	67.430	61.866	218.524	54.660
Porti Vlorë	20.581	15.765	25.355	140.363	19.483	14.571	18.959	100.673	16.221
Hyrje	12.303	6.600	13.444	67.543	12.259	5.626	10.370	49.246	9.991
Dalje	8.278	9.165	11.911	72.820	7.224	8.945	8.589	51.427	6.230
Porti Sarandë (Limjoni)	49.193	10.193	155.620	392.067	61.564	10.620	178.493	497.285	68.288
Hyrje	24.440	4.875	77.741	191.958	30.794	5.199	90.420	243.955	33.692
Dalje	24.753	5.318	77.879	200.109	30.770	5.421	88.073	253.330	34.596
Porti Shëngjin	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Hyrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dalje	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar nëpërmjet porteve detare në vend është 221.628 persona.


Porti i Durrësit është porti nga i cili kanë udhëtuar 61,9 % e pasagjerëve, ndjekur nga porti i Sarandës me 30,8 % dhe më pas porti i Vlorës me 7,3 %.

Eksportet/importet e mallrave me det

Në tremujorin e katërt 2025, volumi i mallrave të tregtuara me det (eksport dhe import) është 1.411 mijë ton. Krahësuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, ky tregues është rritur me 3,5 %.

Volumi i mallrave të eksportuara me det, në tremujorin e katërt 2025, zë 35,3 % ndaj totalit të volumit gjithsej të mallrave të eksportuara.

Volumi i mallrave të importuara me det, në tremujorin e katërt 2025, zë 64,5 % ndaj totalit të volumit gjithsej të mallrave të importuara.

Fig 1: Eksport/import i mallrave me det, ton

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje INSTAT

*(Vlerat per Eksportin Detar janë përditësuar

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit Detar paraqet të dhëna tremujore mbi transportin detar të mallrave dhe pasagjerëve, si edhe mbi eksportin dhe importin e mallrave përmes transportit detar. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave. duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit detar.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete lundruese detare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Port statistikor - Një port statistikor përbëhet nga një ose më shumë porte. të kontrolluara normalisht nga një autoritet i vetëm porti. në gjendje të regjistrojë lëvizjet e anijeve dhe ngarkesave.

Porti i ngarkimit - Quhet porti ku mallrat ngarkohen në anije dhe transportohen prej saj.

Porti i shkarkimit - Quhet porti ku mallrat janë shkarkuar nga anija pasi janë transportuar prej saj.

Transport ndërkombëtar detar - Quhet transporti detar mes dy porteve i lokalizuar në dy vënde të ndryshme.

Pasagjerë detar - Çdo person që kryen një udhëtim në det në një anije tregtare.

Pasagjerë të embarkuar (të dalë) - Janë pasagjerë të cilët kanë hipur në anije dhe transportohen prej saj.

Pasagjerë të disembarkuar (të hyrë) - Janë pasagjerë të zbritur nga anija pasi janë transportuar prej saj.

Pasagjerë/kilometër - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një pasagjeri në një anije tregtare mbi një kilometër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: transport rrugor, hekurudhor, transport ujor i brendshëm dhe transport detar.

Të dhënat e transportit detar janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu..

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>